

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 71/2022

**PËR MOSMIRATIMIN E NJË KANDIDATURE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT
TË LARTË TË PROKURORISË NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË
FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS,
SIPAS LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT
TË DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zonjës Arta Mandro për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit të dytë në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatit për Anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën 22.9.2022